



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

**Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport,
Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media**

Mbledhja nr. 77

Prishtinë, më 29.04.2013, në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala N-10

PROCESVERBAL

**I mbledhjes së Komisionit për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike,
Qeverisje Lokale dhe Media**

Në mbledhje morën pjesë: Idriz Vehapi, Enis Kervan, Xhevahire Izmaqi, Lirije Kajtazi, Sadri Ferati, Afrim Kasolli, Teuta Haxhiu, Jeton Svirca dhe Milivoje Stojanovic, ndërsa munguan: Eqrem Kryeziu, Ramë Vataj,

Në mbledhje mori pjesë, deputetja, Alma Lama, sponsoruese e P/ligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Drita Morina, Shaip Goxhuli dhe Mirjeta Heta.

Mbledhjen e kryesoi, Idriz Vehapi, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e dt 03.04.2013**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, nr. 04/L-137;**
- 4. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.**
- 5. Shqyrtimi i raportit vjetor të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, për vitin 2012;**
- 6. Të ndryshme**

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së komisionit, mbajtur me 03.04.2013

Procesverbali u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë, nr. 04/L-137

Kryetari i komisionit - e njoftoi komisionin me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit të Kosovës, sipas së cilit kërkohet nga komisioni funksional që në afat sa më të shkurtër, të procedojë P/ligjin për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë për mbledhjen plenare. Ai, gjithashtu e njoftoi komisionin edhe me përfundimin e Kryesisë së Kuvendit, nr. 04-P- 105, të dt.1 tetor 2012 sipas të cilit komisioni duhet ti marrë parasysh edhe vërejtjet e Qeverisë lidhur me P/ligjin. Fjalën ia dhe sponzorueses së P/ligjit.

Alma Lama - në cilësinë e propozueses, prezantimin e nismës së P/ligjit në komision e arsyetoi konform rregullave të Rregullores së Kuvendit të Kosovës.

Ajo, tha se, P/ligji është i domosdoshëm për ti mbrojtur burimet e gazetarisë dhe për të garantuar lirinë e shprehjes. Gazetaria luan një rol vital dhe demokratik në ekspozimin e keqpërdorimeve.

Burimet e gazetarisë është e nevojshme të mbrohen me ligj dhe në mungesë të mbrojtjes ligjore të gazetarit dhe profesionistëve të tjerë që punojnë në media detyrohen të tregojnë burimin e informacionit dhe të përballen me sanksione ligjore.

Qëllimi kryesor i P/ligjit për mbrojtjen e burimeve të gazetarisë është krijimi i kushteve për punën e gazetarit në interes të publikut si dhe mbrojtja e tyre nga rreziqet që i kanosen për nxjerrjen e burimit të informacionit.

Sadri Ferati – duke e përkrahur nismën për P/ligjin, ai pati vërejtje për shqyrtimin e P/ligjit në komisionin për Media, duke propozuar që P/ligji të shqyrtohet në komisionin për legjislacion.

Xhevahire Izmaku – ajo tha se P/ligji me përmbajtje të vetëm tetë neneve është i mangët dhe se pas plotësimit-ndryshimit të kodit penal të Kosovës nuk kemi nevojë për një P/ligj për mbrojtjen e burimit të gazetarisë sepse kjo do të ishte duplikim i dispozitave.

Jeton Svirca – propozoi që komisioni ta kryejë punën e vet, të procedojë P/ligjin në Kuvend për miratim në parim.

Afrim Kasolli – mbështeti diskutimin e parafolësit që P/ligji të procedohet në Kuvend.

Teuta Haxhiu – përkrahu nismën për P/ligjin dhe u deklarua se do të votojë “Për”.

Sadri Ferati - tha se në përmbajtje e përkrah P/ligjin por e kundërshton shqyrtimin e tij nga komisioni funksional për Media.

Pas diskutimeve të anëtarëve të komisionit, komisioni votoi, me gjashtë(6) vota Për, një(1) kundër dhe një (1) abstenim, për miratimin në parim të P/ligjit dhe vendosi që Kuvendit, t’ia paraqet këtë :

R e k o m a n d i m

1. Të miratohet në parim Projektligji për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë.

Arsyetim

Në bazë të nenit 56 paragrafi 2 të Rregullores së Kuvendit, Komisioni funksional shqyrton projektligjin në parim para leximit të parë në mbledhje plenare, dhe Kuvendit i paraqet raport me rekomandime për miratim në parim.

Komisioni, pas shqyrtimit, në parim, të Projektligjit për Mbrojtjen e Burimeve të Gazetarisë, vlerësojë së projektligji i plotëson kushtet e parapara sipas nenit 54 të Rregullores së Kuvendit dhe i rekomandon Kuvendit për miratim në parim.

4. Shqyrtimi i Raportit të Qeverisë së Kosovës për gjendjen në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Kryetari i komisionit – hapi diskutimin.

Xhevahire Izmaku - tha se raporti është përshkrues, nuk janë të përfshira sfidat, problemet që ekzistojnë.

Kryetari i komisionit - pyeti anëtarët e komisionit se a pajtohen që dy pikat vijuese 4 dhe 5, të rendit të ditës të shtyhen për mbledhjen e radhës, duke kërkuar përkrahjen e anëtarëve të komisionit që të ftohen përfaqësuesit e institucioneve përkatëse për ti arsyetuar raportet vjetore të institucioneve, bordeve që përfaqësojnë.

Komisioni miratoi unanimisht propozimin dhe vendosi që për mbledhjet e radhës të ftohen përfaqësuesi i Qeverisë, Kryetari i Komisionit të Pavarur për Media, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Kryetari i Bordit të RTK-së.

6. Të ndryshme.

Teuta Haxhiu – kërkoj nga Komisioni, që të formohet Grupi punues për monitorimin e Ligjit për Arsimin e Lartë.

Komisioni miratoi kërkesën e znj. Haxhiu dhe formoi grupin për monitorimin e Ligjit në fjalë me këtë përbërje: Teuta Haxhiu, Xhevahire Izmaku, Lirije Kajtazi, Ramë Vataj, Jeton Svirca dhe Afrim Kasolli.

Mbledhja përfundoi në ora:12:45

Përgatitur nga :

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

**KRYETARI I KOMISIONIT,
Idriz Vehapi**